



Hapet Thirrja për Mobilitete (Bursa) studentësh të UPT-së, në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus +, në Universitetin Politeknik të Torinos, Itali

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës në Universitetin Politeknik të Torinos, Itali.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Bachelor për studime
- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Master për studime
- Shkëmbimin e studentëve të doktoraturës

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- **Bachelor** (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Bachelor në Universitetin Politeknik të Tiranës).
- **Master** (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Master në Universitetin Politeknik të Tiranës).
- **Doktoraturë** (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Doktorature në Universitetin Politeknik të Tiranës).

Kohëzgjatja e bursave:

- Bachelor (1 semestër)
- Master (1 semestër)
- Doktorantët (1 semestër)

Fusha e studimit:

Arkitekturë

Numri total i studentëve në Bachelor, Master dhe në nivel Doktorature: 6

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Bachelor:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash e studimeve Bachelor deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj*;
- Dokumenti Learning Agreement**



Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Master:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Diplomë e nivelit Bachelor;
- Listë notash të studimeve Bachelor;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Listë notash e studimeve Master deri në momentin e aplikimit;
- Çertifikatë e gjuhës së huaj*;
- Dokumenti Learning Agreement**

**ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze dhe në gjuhën italiane, ku niveli minimal i kërkuar për të dyja gjuhët është B2. Nëse do të përzgjidhen lëndë që zhvillohen në të dyja gjuhët, studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar për të dyja këto gjuhë duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘‘Mobility Plan’’. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Politeknik të Torinos lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryeni në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Dokumenti ‘‘Learning Agreement’’ tek seksioni ‘‘Commitment’’ firmoset nga aplikanti, nga koordinatori akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për të shkarkuar formatin e ‘‘Learning Agreement’’ klikoni si më poshtë:

https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/documents/applicants/learning-agreement_en

Dokumentat e nevojshme për aplikim studentët e Doktoraturës:

- CV+Lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti (në gjuhën angleze i lëshuar nga fakulteti juaj që konfirmon nivelin tuaj dhe vitin e studimit gjatë këtij viti akademik);
- Diplomë Master;
- Listë notash të masterit (të përkthyer në gjuhën angleze);
- Letër Motivimi;
- Çertifikatë e gjuhës së huaj* (Italisht/Anglisht);
- Letra konfirmuese nga profesori pritës i Universitetit Politeknik të Torinos**;
- Plani i aktivitetit shkencor të doktorantit dhe periudha e mobilitetit në Universitetin pritës, miratuar nga udhëheqësi shkencor në UPT dhe përgjegjësi i njësisë bazë, përgjegjës për programin e studimit***;



Key Action 1
- Mobility for learners and staff -

**Universiteti Politeknik i Torinos ofron kurset e studimit në gjuhën angleze dhe në gjuhën italiane, ku niveli minimal i kërkuar për të dyja gjuhët është B2.*

***Kandidatët që do të aplikojnë për të qenë pjesë e mobiliteteve në nivel doktorature në Universitetin Politeknik të Torinos, paraprakisht duhet të vendosen në kontakt me një profesor në universitetin pritës, i cili do të udhëheqë periudhën tuaj të studimit gjatë mobilitetit. Ai/ ajo do të duhet t'ju dërgojë një dokument paraprak për të qenë profesori juaj udhëheqës, të cilin do të duhet ta bashkangjisni me dokumentet e tjera të kërkuara për aplikimin tuaj.*

****Kandidatët që do të aplikojnë për të qenë pjesë e mobiliteteve në nivel doktorature në Universitetin Politeknik të Torinos, paraprakisht duhet të paraqesin një plan të aktiviteteve shkencore ose lëndëve teorike të parashikuara të ndiqen në Universitetin pritës. Ky plan së bashku me periudhën e planifikuar të mobilitetit duhet të firmosen nga udhëheqësi shkencor i kandidatit në UPT dhe përgjegjësi i njësisë bazë ku program i studimit ose kandidati bën pjesë.*

Afati për aplikim për studentët: deri më 27 Maj 2021

Aplikimi kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT. Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në e-mail: rkodra@upt.al